

Ditari Naturës



Nr. 43 Viti i katërt i botimit Dhjetor 2016

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Plani Zonimit për RNM të Liqenit të Shkodrës / N.Dragoti
- Inventari për Sistemin e Monitorimit të Faunës së Egër
- Planifikimi Hapësinor Detar në Gjirin e Vlorës
- CO-SEED / workshop për ngritjen e kapaciteteve
- Forumi i Zonave të Mbrojtura Detare në Mesdhe
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 21 vjet më parë ...

...me Urdhër të Ministrisë së Bujqësisë nr.2, dt. 26.12.1995, territori lagunor, pyjet aluvional dhe pjesë e dunave ranore të Krushkullit-Rrotull, me sipërfaqe 650 ha, rishpallet Rezervat Gjuetie, i shpallur për herë të parë në dt. 07.07.1956, me sipërfaqe 1286 ha.

Me udhër nr.404, dt. 25.01.1983, sipërfaqja e rezervatit të Krushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës. Pas miratimit të ligjit për Zonat e Mbrojtura ky

rezervat u njehësuar me statusin, sipas IUCN, "Rezervat Natyror i Menaxhuar". Gjendja është tepër e rënduar, përshkak se ky territor është dhënë për mbarështimin e faunës së egër. Në fakt aty rriten në kushte jo normale edhe kafshë e shpendë që nuk i takojnë këtij rezervati, pra ka humbur funksionet dhe statusin e Zonës së Mbrojtur të Menaxhuar...


... 14 vjet më parë ...

...me YKM nr.676, dt.20.12.2002, shpallen "ZONË E MBROJTUR" 750 njësi Bio dhe Gjeo Monumente të Natyrës Shqiptare...



Rezerva Natyrore e Menxhuar e Liqenit të Shkodrës © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



...8 vjet më parë ...

...me VKM nr.1631, dt.17.12.2008, ekosistemi natyror-malor i Bredhit të Hotovës-Dangëlli, me sipërfaqe 34,361.1ha, shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar, pasi në të u përfshi dhe territori, kryesisht bredhishtja, me sipërfaqe prej 4200 ha i "Bredhit të Hotovës", i shpallur park kombëtar, me VKM nr. 102, datë 15.01.1996. Për këtë park kombëtar, me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menaxhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht ai mbi lumin e Langaricës, i cili cënon rëndë kanionin dhe ujërat termale të Bënjës...

...5 vjet më parë ...

...me VKM nr.898, dt.21.12.2011, ekosistemi natyror-malor i Korab-Koritnikut, me sipërfaqe 55,550.2 ha, të shtrirë në qarkun e Dibrës dhe të Kukësit, shpallet "Park Natyror". Me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menaxhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht mbi lumin e Lumës dhe të Radomirës.

Plani i zonimit për Rezervën Natyrore të Menaxhuar të Liqenit të Shkodrës

Më datën 4 Nëntor 2016, në Shkodër, Hotel Rozafa, u organizua takimi përmblyllës për aktivitetet e projektit "Mbështetje për menaxhimin e qëndrueshëm afatgjatë të Liqenit ndërkufitar të Shkodrës". Në takim morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i AKZM z. Z. Dedej, Drejtori i IUCN për Evropën Juglindore z. O. Avramoski, Presidenti i INCA z. G. Kromidha, përgaqësues të komunitetit akademik Shkodër, të shoqërisë civile, të medias etj.

Plani i zonimit për Rezervën Natyrore të Menaxhuar të Liqenit të Shkodrës", u mbështet nga Bashkimi Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës (IUNC) dhe Ministria e Mjedisit (MM), i financuar nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike (Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF). Studimi është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet IUCN, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM), qarku Shkodër.

Ky event kishte qëllim të ndante me aktorët kryesor rezultatet përfundimtare të procesit të rishikimit dhe riplanifikimit të zonimit të RNM "Liqeni i Shkodrës", me synim për mirësimin e administrimit dhe menaxhimit të tij nëpërmjet arritjes së standarteve rajonale dhe ndërkombëtare. Njëherazi edhe për vlerësimin dhe promovimin e vlerave dhe të përdorimit të barazpeshuar dhe të mençur të burimeve natyrore që ai disponon dhe janë jetike për

popullsinë lokale.

nga Nihat Dragoti

Me këtë event përmblyllës, krahas promovimit të rezultateve kryesore, u synua edhe vijimi i bashkëpunimit ndërkufitar, midis të gjithë aktorëve lokal në të dy pjesët e Liqenit, si një ekosistem i tërë dhe pa ndarje kufijsh, në lidhje me mbrojtjen dhe menaxhimin e tij, sipas standarteve ndërkombëtare.

Realizimi i këtij projekti ka qënë një proces gjithë përfshirës dhe i bazuar mbi një qasje metodike të mirë hartuar dhe bashkëkohore, i ndjekur nga një grup pune, të krijuar dhe drejtuar nga Drejtori i AdRZM Shkodër, z. A.Dardha dhe Shefi e Menaxhimit, z.T.Macaj. Një kontribut të veçantë, kanë dhënë edhe ekspertët ndërkombëtar z. G. Loiskandl, z. T. Pezold dhe z. Oliver Avramoski.

Në procesin e zbatimit të projektit dhe të metodikës, kujdes i është dhënë skanimit të gjendjes së biodiversitetit, të tipeve të habitateve dhe specieve si dhe caktimit të masave konservuese dhe menaxhues që duhen rishikuar dhe riplanifikuar, nëpërmjet rivlerësimit të nënzonave të menaxhimit, në përputhje me kushtet e zhvillimit social-ekonomik, të infrastruktures, planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të interesave të aktorëve lokal. Në këtë drejtim falënderoj të tre profesorët e nderuar të Universtitetit të Shkodrës, për kontributin e dhënë, z. Dh.Dhora, z. M.Rakaj dhe z. Rr.Smalaj.

Bazuar në shqyrtimin e *Vijon në faqe 3*

Vijon nga faqe 2 dokumentacionit ekzistues dhe të të dhënave ekzistuese të disponueshme, theksi është vendosur në përmbledhjen dhe vendosjen e tyre në kontekstin real të gjendjes dhe sipas bazës ligjore në fuqi, duke identifikuar njëherazi të dhënat dhe njohuritë të cilat mungojnë apo që janë të nevojshme për t'u përfshirë në procesin e rizonimit të territorit. Në këtë mënyrë përmirësohen rekomandimet e më parshme dhe përgatiten udhëzimet e nevojshme të përditësuara për veprimtaritë e ardhshme të mundshme për t'u zhvilluar. Kësisoj u përcillet administratës së RNM, organeve të njësive të qeverisjes vendore, OM Peshkimit, komunitetit të biznesit e të turizmit si dhe vizitorëve informacione më të detajuara në secilin nën zonë administrimi mbi ekosistemin natyror të Liqenit të Shkodrës.



Bashkëpunimit me grupet e interesit ka qënë në një nivel të mirë dhe gjithë përfshirës. Takime rezultative kemi patur me grupin e peshkatarëve, me të cilët kemi diskutuar gjatë problemet e menaxhimit të peshkimit, të mjeteve që duhen përdorur si dhe caktimin e zonave konkrete të ndalimit të peshkimit, të cilat do të shërbejnë për shtimin e peshkut, por edhe për speciet e zogjëve. INCA me AdRZM dhe OMP, krahas shkëmbimit të ideve dhe punës që duhet bërë për mirëmenaxhimin e burimeve peshkore, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi 2 vjeçare (Maj 2015), në këto drejtime: (i) Kontributi në mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave natyrore të liqenit të Shkodrës; (ii) Promovimi i aktiviteteve dhe projekteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e Liqenit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore dhe turistike, (iii) Krijimi i mundësive për gjetjen e

financimeve për aktivitete të përbashkëta në Liqen, (iv) Pjesëmarrje e përbashkët në aktivitete me karakter mjedisor brenda dhe jashtë vendit (eksperiencia në Austri), (v) Koordinimi i punës për patrullimin e përbashkët. Për këtë falënderoj z. Gëzim Lezaj, Kryetar dhe z. Arjan Çinari, menaxher i OMP.

Po kështu, i rëndësishëm ka qënë dhe bashkëpunimi edhe me aktorët e tjerë të biznesit, të ekoturizmit dhe specialistët e njësive të qeverisjes vendore që u përfshin në këtë proces dhe përkontributin e tyre.

Gjithashtu, është punuar për ndërgjegjësimin dhe promovimin e vlerave atyrorë, historike dhe ekoturistike të RNM, për të cilat janë zhvilluar disa takime me mediat lokale e kombëtare si dhe me ato ndërkufitare, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta. Aktivitete ndërgjegjësuare dhe konkrete kemi zhvilluar dhe me nxësësit e shkollës së Stërbeqit, me tematike "I love Shkodra lake", si dhe të festimit të Ditës së Biodiversitetit, në Shirokë, etj.

Mjaft aktivitete janë ndarë edhe me kolegët e Malit të Zi, duke shkëmbyer informacione dhe organizuar takime të ndërsjellta, për problemet e menaxhimit të Liqenit si një Ekosistem i tërë dhe i përbashkët. Bashkëpunim i frytshëm u arrit me institucionet përgjegjëse shtetërore të ZM, të Malit të Zi, me Administratorët e Parkut Kombëtar të pjesës Malazeze si dhe me kolegët e Green Home, duke shprehur që ky bashkëpunim do të forcohet në të ardhmen.

Në punë për realizimin e objektivave të rishikimit dhe riplanifikimit të zonimit të territorit të RNM kemi bashkëpunuar dhe me projektet që zhvillohen nga donatorë të tjerë, si: Projekti për të tre Liqenët, i mbështetur nga GIZ; Projekti "Menaxhimi i ligatinave dhe ruajtja e Pelikanit Kaçurrel, në pellgun e Mesdheut", i mbështetur nga NOE, dhe Projekti NaturaAl, në kuadër të programit IPA 2013, ku ky ekosistem është pjesë e studimit për Rrjetin Natura 2000.

Realizimi i këtij projekti dhe rezultatet pozitive të arritura janë edhe në saj të mbështetjes që ka dhënë dhe jep IUCN, të Bashkive Shkodër dhe Malësia e Madhe, të Ministrisë së Mjedist dhe të AKZM.

Inventari për Sistemin e Monitorimit të Faunës së Egër

Tiranë, 11,14 Nëntor 2016 - Përfundoi trajnimi mbi Inventarin për sistemin e monitorimit të faunës së egër me shefat e monitorimit dhe të menaxhimit të 12 AdRZM-



ve të vendit.

Ky sistem synohet të krijohet për regjistrimin dhe monitorimin e faunës së egër dhe do të jetë dokumenti kryesor që shërben për mbrojtjen dhe menxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe komponentëve të tij si dhe për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë.

Qëllimi kryesor i këtyre aktivitetëve ishte të përpunojë informacionin e duhur përmes monitorimit që do të vijë nga ranger-sat në terren, lidhur me tendencat në popullatat e faunës së egër si dhe mbi trysinë dhe kërcënimet në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i ruajtjes dhe vendimarrja ndaj saj.

Gjatë trajtnimit shafat e monitorimit dhe menaxhimit të AdRZM-ve u njohën me proceset e përpunimit të informacioneve, parimet dhe detyrimet e sistemit të monitorimit të faunës së egër (SiMF), monitorimi e jetës së egër, përdorimin i Sistemi Global të Pozicionimit (Global Positioning System-GPS), aktivitetet e jashtëligjshme, prezantimi me NATURA 2000 etj.

Ata u njohën me mënyrën e plotësimit të formularët dhe formatet e nevojshme të hartuar në përputhje me kërkesat e Direktivës Evropiane në shërbim të procesit të monitorimit, por edhe se si do të kryhen patrullimet dhe mënyrat e raportimi.

Në trajnim morën pjesë shefat e monitorimit dhe menaxhimit të 12 AdRZM-ve si dhe ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës.



Planifikimi Hapësinor Detar në Gjirin e Vlorës

Vlorë, 15-17 Nëntor 2016 - Jeta e komuniteteve lokale në zonat bregdetare



është e varur nga ekosistemet detare të cilat mundësojnë prodhimin e ushqimit, mallrave dhe shërbimeve për jetesën e tyre. Mjediset e shëndetshme bregdetare dhe detare janë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë dhe brezat e ardhshëm, ndërkohe që nga viti në vit kërkesat për burimet bregdetare dhe detare në Shqipëri janë gjithmonë në rritje, të cilat korrespondojnë edhe me kërkesën për hapësirë detare. Burimet detare dhe hapësira janë të kufizuara, dhe së shpejti kërkesat do të jenë më të mëdha, të cilat mund të shkaktojnë konflikte midis përdoruesve dhe humbje të biodiversitetit detar.

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 Për ti paraprirë këtyre konflikteve është i rëndësishëm parashikimi dhe menaxhimi i përdoruesve në varësi të hapësirës, ndjeshmërisë së zonave, objektivave të menaxhimit dhe kërkesës për hapësirë dhe burime të përdoruesve nëpërmjet procesit të planifikimit hapësinor detar. Planifikimi hapësinor detar është një proces i dobishëm për të parë shkaqet e rritjes aktuale dhe për të parashikuar kërkesën hapësinore në të ardhmen.

Shqipëria është në fillimet e këtij procesi, por është e rëndësishme të kuptohet rëndësia në



dizenjimin dhe zbatimin e tij nga grupet e interesit në bashkëpunim.

Nisur nga këto arsye dhe në kuadër të zbatimit të projektit “Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare në Mesdhe - (Shqipëri), INCA organizoi trajnimin 3 ditor “Hyrje në konceptin e planifikimit hapësinor detar dhe nevoja për zbatimin e tij në Shqipëri”. Në trajnim u dhanë njohuri mbi rëndësinë dhe hapat e këtij procesi.

Trajnimi u mbajt nga eksperte Amerikanë të fushës të cilët kanë eksperiencë të gjatë në zhvillimin dhe zbatimin e tij në vendin e tyre.

CO-SEED / workshop për ngritjen e kapaciteteve

Stamboll, 14-16 Nëntor 2016 - Në kuadër të projektit “Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm” (CO-SEED), u zhvillua workshop-i për krijimin e rrjetit të OSHC-ve partnere dhe perfituese nga zbatimi i projektit duke u fokusuar në edukimin e OSHC-ve për advokim të politikave dhe mbulimin e të gjitha aspekteve të procesit të VNM/VSM - nga deklarimi i problemeve, analizën e grupeve të interesit, zhvillimit të strategjisë dhe do të fokusohet në mënyrë të veçantë në atë se si do të monitorohet progresi dhe vlerësimi përfundimtar të politikës dhe punës advokuese. Ky workshop kishte në agjendën e tij edukimin e pergjithshem për advokaci dhe lobim dhe finalizimin e raporteve të analizës së bashkëpunetoreve për zbatimin e projektit.

Projekti CO-SEED po zbatohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Serbi dhe Turqi. Partneri kryesor që drejton zbatimin e projektit është WWF Turqi. Partnerët e projektit janë: INCA Shqipëri, Udruga Dinarica, Bosnia dhe

Hercegovina, WWF Adria, Kroaci, Zeleni Dom - Green Home, Mal i Zi dhe Shoqata e Studimeve Shoqërore dhe Mbrojtjes së Shpendëve të Serbisë.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian përmes programit të lehtësimit të Shoqërisë Civile dhe mediave të Bashkimit Evropian 2014-2015 - Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.



Forumi i Zonave të Mbrojtura Detare në Mesdhe

Marok, 28 Nëntor - 1 Dhjetor 2016 - Çdo 4 vjet, Forumi i Zonave të Mbrojtura Detare (ZMD) në Mesdhe gjeneron një proces unik, gjatë të cilit menaxherët, politikbërësit, aktorët social-ekonomikë, shoqëria civile dhe komuniteti shkencor, trajtojnë në të gjitha nivelet sfidat e zhvillimit të ZMD-ve. Edicioni i Forumit 2016, i cili po zhvillohet nga 28 nëntor-1 dhjetor 2016, përbën një moment historik të rëndësishëm nga pikëpamja e afatit 2020 mbi objektivat e Konventës mbi shumëllojshmërinë biologjike.



Ky event vlerësoi progresin e bërë deri tani dhe çfarë ka mbetur për tu bërë në të ardhmen, në përputhje me udhërrëfyesin e ZMD-ve të zhvilluar në Forumin e Turqisë më 2012.

INCA mori pjesë në mënyrë aktive në këtë event, si pjesë e komunitetit që po punon dhe kontribuon në ruajtjen e ZMD-ve të Mesdheut. Më 27-28 nëntor, gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjes së Komitetit Drejtues, u diskutuan hapat dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të zonave bregdetare dhe detare të mbrojtura në Shqipëri.

NJOFTIME

5 Dhjetor - Dita Botërore e Tokës

11 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Maleve

1 - Për të lexuar “Ditari i Natyrës” në vite... / <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
 Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania